Takim koordinues i partnerëve të projektit Erasmus+ CBHE SINCERE

Në kuadër të zbatimit të projektit ndërkombëtar Erasmus+ CBHE SINCERE – "Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education", më datë 20 tetor 2026, u zhvillua online takimi koordinues i partnerëve të konsorciumit, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër.

Qëllimi kryesor i takimit ishte shqyrtimi përfundimtar dhe miratimi i dokumentit D1.4 – Quality Plan (Plani i Sigurimit të Cilësisë), të përgatitur nga partneri WEBIN Institute dhe të përditësuar në përputhje me rekomandimet e Project Officer.

Dokumenti, i shqyrtuar paraprakisht nga partnerët e konsorciumit, pas diskutimeve dhe disa sugjerimeve për përmirësim, u miratua nga Komiteti Drejtues (Steering Committee) për dorëzim në platformën zyrtare SyGMa.

Ky takim përbën një hap të rëndësishëm në garantimin e cilësisë së zbatimit të projektit, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmbushjen e objektivave të përbashkëta. Plani i Sigurimit të Cilësisë shërben si një instrument udhëzues për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve dhe rezultateve të projektit.

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër, vijon angazhimin e tij aktiv në realizimin e projektit SINCERE, duke kontribuar në promovimin e integritetit akademik, forcimin e kulturës etike dhe përmirësimin e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.